



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafët 1.21 dhe 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Memorandumin e Bashkëpunimit për themelimin dhe funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për ndjekjen e kryerësve të veprave penale edhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale dhe Planit strategjik për bashkëpunim ndërinstitutional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 për Hartimin e Akteve Normative të KPK-së, më.....miraton:

**RREGULLORE NR. __/2025
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR THEMELIMIN
DHE FUNKSIONALIZIMIN E KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR LUFTIMIN E
KRIMIT EKONOMIK**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Themelimin dhe Funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (në tekstin e mëtejme: Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik), me qëllim të përcaktimit të mandatit, vlerësimit të punës së Koordinatorit Kombëtar dhe përgjegjësitë e tjera, të parapara sipas memorandumit.

Neni 2

Plotësohet dhe ndryshohet titulli i **Nenit 7**, si në vijim:

Mbikëqyrja, mandati dhe vlerësimi i punës së Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

Neni 3

Neni 7 plotësohet si në vijim:

Paragrafi 6: Mandati i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik është tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat pas vlerësimit pozitiv të punës.

Paragrafi 7: Këshilli Prokurorial i Kosovës bënë çdo vit vlerësimin e punës së Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, duke u bazuar në përgjegjësitë dhe detyrat e

përcaktuara me rregullore, përmes një komisioni të themeluar nga ana e tij, në përbërje të të cilit janë dy (2) anëtarë të Këshillit dhe një (1) prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 4

Shtohet **neni 9**, kurse neni 9 ndryshohet dhe bëhet 10.

Neni 9 Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, Këshilli Prokurorial i Kosovës cakton me vendim Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, sipas mandatit të paraparë në këtë rregullore.

Neni 10 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më _____ 2025

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës